



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR
NJESIA E PROKURIMIT**

Data: 27.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje pjese kembimi.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pjesë kembimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash (34330000-9)

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.500.000 (Dy milion e peseqind mije) **leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA DIBER ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, pika 1, 82 pika 1 dhe 83 pika 1 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, të LPP, *ky kriter kërkohej sepse vërtetohet se operatorët ekonomik kanë kapacitetet e duhura ligjore për kryerjen e furnizimeve të mallrave*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2020,2021,2022 ku vlera mesatare e të tre viteve të jete jo më e vogël se 40 % e fondit limit, të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga administrata tatimore.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Ky kriter vendoset për të siguruar operatorët ekonomik kapacitetet financiare të duhura për përmbushjen e kushteve të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 2 germa c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërtetohet se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitetet për vetet 2020,2021,2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Shënim: Per këte pike 2.2.2 të mesiperme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Kjo bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, kontratë/a të ngjashme, të kryera dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit në **vlerë jo më e vogël se 20%** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.1.a Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontratë/a të shoqëruara me vërtetim/e të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

2.3.1.b Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 4 nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Ky kriter është përcaktuar dhe dhe vërtetuar eksperiencen e mëparshme të operatorëve ekonomikë.

2.3.2/1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ne pronesi ose me kontrate qeraje të noterizuara ambjent servisi të pershtatshëm për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate.

Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave të cilat vërtetojnë pronesinë e objektit ose kontratën e qerasë të noterizuar të objektit të servisit. Në rastin e marjes me qera të pikës së servisit të paraqitet dokumenti i cili vërteton pronesinë e objektit nga qeradhënesi

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.2/2. Per ambjentet e servisit te paraqiten Foto te realizuara ne ambientet e brendshme dhe te jashtme te servisit me qellim evidentimin nga antaret e komisionit te vleresimit te oferteve te vendndodhjes se objektit pike servisi.

Argumentim: Në bazë të të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.2/3 Ambjenti i servisit, te ndodhet brenda territorit te Bashkise Diber, kjo si rrjedhoje e vendndodhjes se mjeteve dhe me qellim kryerjen sa me me eficence te sherbimit te kerkuar

Argumentim: Në bazë të të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion servisin brenda territorit të Bashkise Diber me qellim që të kryhet procedura në mënyrë me eficence të shërbimit të kërkuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

NJESIA E PROKURIMIT